

NJË STUDIM KRAHASUES I PROVERBAVE NË GJUHËN ANGLEZE DHE ATË SHQIPE. PËRDORIMI I KAFSHËVE NË DISA PROVERBA

Dr. KRISTINA AJAZI

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

kristina.ajazi@unitir.edu.al

ABSTRACT

The aim of this paper is to analyse English and Albanian proverbs which contain animal names. By highlighting the similarities and differences from a cultural standpoint, we will try to find the equivalences between them. Proverbs, in nature, are greatly associated with culture. In both form and meaning, they are concise and comprehensive, vivid in images and select materials widely, delivering all sorts of physiological information and cultural knowledge and explicitly expressing all human beings' life, social and historical experience. Every country has proverbs that are unique to it. Proverbs reflect people's culture and generally are related to a nation's culture. They are effective devices of truth about culture, religion, tradition, custom and belief. The present study tries to find out the cultural differences in the concept of animals through English and Albanian proverbs.

Keywords: translation, proverbs, animals, equivalence.

1. Hyrje

Proverbat janë përdorur në gjuhë të ndryshme për një kohë shumë të gjatë. Ato janë të lidhura me historinë, politikën, kulturën, fenë dhe traditën e vendeve përkatëse. Duke qenë se proverbat janë pjesë e një shoqërie apo kulture të caktuar, ato pasqyrojnë të gjitha tiparet e një shoqërie (traditat, zakonet, demokracinë, barazinë, gjininë...) dhe

anasjelltas. Pra, proverbat e një vendi të caktuar mund të përcaktojnë disa veçori për shoqërinë dhe kulturen. Pjesërisht për shkak të rolit të tyre didaktik, proverbat janë të përhapura në shumë ndërveprime komunikuese; si formale ashtu edhe informale. Pikërisht, për këtë arsye, në kuadër të këtij studimi, ne kemi zgjedhur të bëjmë krahasimin e proverbave angleze dhe shqiptare të cilat përmbajnë në brendësinë e tyre emra të kafshëve, bazuar në disa shembuj të cilët i kemi nxjerrë nga fjalorë dhe artikuj si në gjuhën angleze ashtu edhe në gjuhën shqipe, por edhe duke marrë parasysh proverbat që kanë frekuencë më të madhe në përditshmërinë tonë.

2. Përkufizime mbi proverbat

Çdo kontekst komunikues ka fjalë të urta (proverba) të përshtatshme, të cilat ‘injektohen’ në ligjërim për të arritur shumë efekte, përfshirë këtu edhe zbukurimin e saj. Shumica e rrethanave dhe përvojave në jetën tonë të përditshme fshihen në mënyrë inteligjente në proverbat tradicionale që u përkasin gjuhëve dhe kulturave të veçanta. Studimi i proverbave quhet paremiologji (me prejardhje nga fjala greke “παροιμία – paroimía”, “fjalë e urtë”) dhe daton qysh nga kohet e lashta. Sipas Kindstrand (1978) dhe Russo (1983) “përkufizimi i proverbave ka shkaktuar shumë kontradita ndërmjet studiuesve të shumë disiplinave përgjatë shekujve”¹.

Shumë përpjekje për të dhënë një përkufizim janë bërë që nga Aristoteli e deri në kohët e sotme, duke filluar nga përkufizimet filozofike deri tek ato përkufizime të prera leksikografike”. Meider (1985: 119) e ka përkufizuar proverbën si “një fjali e shkurtër, e njohur përgjithësisht nga populli, e cila përmban të vërtetën, moralin dhe pikëpamjet tradicionale në një formë metaforike, fikse, që mund të mbahet mend lehtësisht dhe që përcillet brez pas brezi. Ai gjithashtu shkurtimisht i përkufizon proverbat si: “Proverbat janë rezultat i përvojës”, “Proverbat janë mençuria e fituar nga eksperiencia” si edhe “Proverbat janë fjalë të vërteta”². Mollanazar (2001: 53) e ka përkufizuar proverbën si “një njësi

¹ Kindstrand JF (1978) The Greek Concept of Proverbs; Russo J (1983) The Poetics of an Ancient Greek Proverb.

² Meider, W. (2004). Proverbs: A handbook/119

kuptimore në një kontekst specifik përmes të cilit folësi dhe dëgjuesi arrijnë në të njëjtin kuptim”³.

Ndërsa Norrick (1985:78) ka propozuar përkufizimin e mëposhtëm për proverbin: “Proverbi është një zhanër tradicional, bisedor, didaktik me kuptim të përgjithshëm dhe me shumë gjasa me kuptim figurativ”⁴.

Prej disa kohësh, studimet në ‘paremiologji’ kanë tërhequr interesin e shumë studiuesve në mënyrë që të njohin dhe të thellojnë njohuritë në aspekte të ndryshme të këtij koncepti. Ka pasur kërkime të mëdha mbi proverbat nga këndvështrimet e semantikës, pragmatikës, sociolinguistikës dhe socio-kulturore. Dihet shumë për proverbat, funksionin e tyre, si tingëllojnë, sa të vjetra janë dhe çfarë historie qëndron pas tyre, por ka ende shumë debate se çfarë saktësisht përbën një proverb. Proverbat janë fraza të shkurtra që shprehim me pak fjalë filozofinë popullore (urtinë popullore).

Pikërisht për këtë, ato thirren nga populli edhe fjalë të urta. Proverbat janë të përhapur në të gjithë botën dhe nuk ka dyshim se midis tyre hasen edhe ngjashmëri apo identitete. Megjithatë, çdo popull ka proverbat e tij, të ndërtuara sipas psikologjisë dhe përvojës së tij jetësore, filozofike e historike. Ka raste kur është e lehtë të caktohet pak a shumë “mosha” e një proverbi të caktuar, sidomos kur flasim për gjuhën shqipe pasi prania e turqizmeve mund të jetë dëshmi e moshës, çka provon se proverba mund të kenë lindur pas pushtimit otoman të Shqipërisë por ama kjo nuk e përjashton mundësinë që këto proverba të kenë lindur më parë e më pas të kenë pësuar këtë transformim të lehtë që nuk prek brendinë, por vetëm anën e jashtme. Gjithsesi të gjithë studiuesit bien dakord se është e vështirë aq më tepër me kalimin e kohës, kur proverbat edhe ndryshojnë e mund të marrin edhe trajta disi të ndryshme. Proverbat flasin për dukuri dhe situata të ndryshme në jetën e njeriut. Në to shpaloset qartë filozofia e popullit dhe ne gjejmë në to vlerësime për shumë dukuri e anë të jetës. Në këtë vështrim ato janë mësim të vërteta megjithatë do të ishte punë e kotë të orvateshe e të gjeje një konsekuencë të plotë në të gjitha proverbat: shpeshherë për të njëjtën dukuri mund të hasen vlerësime të ndryshme, madje edhe të kundërta. Kjo vjen nga fakti se proverbat

³ Mollanazar, H. (2001). Principles and Methodology of Translation/53

⁴ Norrick, N.R. (1985). How Proverbs Mean? Fq.78

janë krijuar nga njerëz e shtresa të ndryshme dhe për këtë nganjëherë është e vështirë të shmangen ndryshimet. Sidoqoftë ka proverba që flasin për jetën, për dukuri shoqërore për natyrën e njeriut, për cilësitë dhe të metat e tij, për natyrën, për familjen, për detyrat e secilit etj.

3. Funksionet e proverbave

Të gjitha ose pothuajse të gjitha gjuhët (disa gjuhë më të pasura me proverba se të tjerat) zotërojnë një repertor proverbash dhe i përdorin ato kryesisht si mjete retorikisht efektive për transmetimin e njohurive dhe përvojës së akumuluar. Proverbat janë pjesë e të folurit që mund të përdoren në çdo aspekt të diskutimeve si edhe në jetën e përditshme për të trajtuar situata të ndryshme ose thjesht në bashkëbisedim të lirë.

Sa i përket funksioneve të proverbave, Honeck (1997:26-29) ka propozuar funksionet e mëposhtme për to⁵:

a. Funksioni letrar

Proverbat përdoren në prozë, poezi dhe këngë. Arsyet e përdorimit ndryshojnë sipas zhanrit. Poezia dhe kënga priren të ndjekin struktura të caktuara ritmike, kështu që struktura poetike dhe e ekuilibruar sintaksore e disa proverbave mund të jetë tërheqëse. Ndoshta arsyeja më thelbësore pse proverbat shfaqen në burimet letrare është se ato përmbajnë një dukuri emocionale dhe estetike.

b. Funksioni praktik

Funksioni tjetër që Honeck (po aty) klasifikon për proverbat është përdorimi i tyre në situata praktike. Proverbat kanë veti karakteristike që i bëjnë ato të dobishme për qëllime të përditshme. Ato janë relativisht të shkurtra, poetike, konkrete dhe mund të përdoren si komente indirekte. Ato kanë mençurinë e shumë njerëzve pas tyre dhe kryejnë funksione kategorizimi dhe pragmatike. Sigurisht, këto veti janë pikërisht arsyeja pse shumë proverba zhvillohen në kultura dhe gjuhë të ndryshme.

⁵ Honeck, R. (1997). A proverb in mind: the cognitive science of proverbial wit and wisdom. Fq.26-29

4. Përkthimi i proverbave

Përkthimi i proverbave nuk është aspak një punë e thjeshtë. Çështjet kulturore që mund të ndikojnë në përkthim, e sidomos në përkthimin e proverbave janë diskutuar nga shumë studiues si Baker (1992) dhe Newmark (1988).

Sipas Newmark (1988), ka shumë probleme gjuhësore me të cilat përballlet një përkthyes gjatë përkthimit si gabime në përdorim që vijnë nga mungesa e kompetencës së përkthyesit për të shkruar siç duhet, përdorimi i i fjalorëve të gabuar, përkthimi fjalë për fjalë ose thjesht mungesa e eksperiencës së përkthyesit.

Baker (1992, F. 68-70) përshkruan vështirësitë e hasura gjatë përkthimit të proverbave si më poshtë:

- Mungesa e ekuivalencës në gjuhën e synuar
- Disponueshmëria e proverbës në gjuhën e synuar, por përdorimi i saj në kontekst mund të jetë i ndryshëm⁶.

Çdo kulturë ka strukturën e vet gjuhësore që e bën atë të veçantë. Pra, proverbat në çdo gjuhë kanë struktura të ndryshme, gjë që e bën të vështirë përkthimin e tyre.

Pasi një proverbë lexohet dhe kuptohet saktë, hapi tjetër është se si ta përkthejmë atë në gjuhën e synuar. Vështirësitë e përfshira në përkthimin e një proverbe janë krejtësisht të ndryshme nga ato që përfshihen në kuptimin e saj. Këtu, pyetja nuk është nëse një proverbë e dhënë është transparente, e lehtë apo e vështirë për t'u kuptuar. Mënyra se si proverbë mund të përkthehet në një gjuhë tjetër varet nga shumë faktorë. Nuk është vetëm çështja nëse një proverbë me një kuptim të ngjashëm është e disponueshme në gjuhën e synuar. Këtu përfshihen faktorë të tjerë, për shembull, rëndësia e njësive specifike leksikore që përbëjnë proverbën, si dhe përshtatshmërinë ose papërshtatshmërinë e përdorimit të gjuhës idiomatike në një regjistër të caktuar në gjuhën e synuar.

5. Përdorimi i kafshëve në disa proverba dhe kuptimi i tyre metaforik.

Çfarë është metafora? Në konceptet tradicionale, metafora është thjesht një lloj fenomeni gjuhësor, i cili përdoret për të dekoruar ligjërimin.

Aristoteli pohon se metafora është një krahasim ose ngjashmëri midis dy ose më shumë objekteve që nuk i përkasin të njëjtës kategori dhe ai i merr të gjitha ngjashmëritë si metafora. Aristoteli e sheh metaforën si një lloj dekorimi të gjuhës së zakonshme e të thjeshtë dhe një mjet retorik që përdoret në kohë të caktuara për të fituar efekte të caktuara. Nga këndvështrimi i Aristotelit, metafora është diçka jashtë gjuhës normale dhe kërkon forma të veçanta interpretimi nga dëgjuesit ose lexuesit.

Metaforat duke përdorur kafshët, veçanërisht në proverba, janë përdorur gjerësisht për të portretizuar disa tipare të sjelljes që lidhen me qeniet njerëzore.

Përmendëm edhe më lart se një nga veçoritë kryesore të proverbit është kuptimi figurativ i tij. Mbi të gjitha figurat e shprehjes artistike me së shumti përdoret metafora. Përmes kuptimit të bartur proverbi shpreh ide, pikëpamje dhe i vë në dukje vyrtytet dhe të metat e njerëzve. Kështu, si në kulturën angleze edhe në atë shqiptare qeni personifikon besnikërinë, dhelpra është tinëzare e hileqare ndërsa lepuri është frikacak dhe i shpejtë. Pra nuk janë të rralla rastet kur përdorim kafshët, shpendët për të evidentuar disa atributë jo të natyrshme të njerëzve.

Në një krahasim të të dy gjuhëve duke marrë anglishten si gjuhë burimore dhe gjuhën shqipe si gjuhë të synuar vërejmë se kemi ekuivalencë të plotë semantike e kuptimore në disa raste, psh: “A barking dog seldom bites” - kuptimi i të cilës është që nuk duhet ti trembemi një njeriu që flet e bërtet shumë. Në gjuhën shqipe përdorim një proverb pothuaj identik për të shprehur të njëjtën gjë “Qeni që leh nuk kafshon”.

The dog barks but the caravan moves on – kuptimi i të cilës është mos i kushtoni vëmendje asaj që njerëzit thonë për ju. Edhe në shqip e shprehim nëpërmjet proverbës: Qentë le të lehin, karvanet të

shkojnë përpara. When cat is away the mice will play – kuptimi I të cilës është njerëzit do të sillen keq ose si të duan kur një mbikëqyrës nuk është i pranishëm. Proverbi ekuivalent në gjuhën shqipe do të ishte “Kur macja ikën, minjtë hedhin valle”. “Like a fish out of water” kuptimi i të cilës është: një person në një mjedis ose situatë krejtësisht të papërshtatshme. Proverbi ekuivalent në gjuhën shqipe është “Si peshku pa ujë”. Por në të njëjtën mënyrë që ekzistojnë ngjashmëri midis proverbave anglisht dhe shqip, ekzistojnë edhe dallime. Në rastin kur përkthimi i fjalëpërfjalshëm nga gjuha burimore në atë të synuarën nuk është i mundur, përkthyesi mund të zbatojë përkthimin komunikativ, duke përkthyer një proverb me një proverb tjetër, të formuar nga njësi të ndryshme leksikore, por që mund të përdoren në situata të njëjta.

a. Kafshë e zëvendësuar me një kafshë tjetër

Proverbat në vijim kanë ekuivalentet e tyre me të njëjtin kuptim apo të ngjashëm, por përdorin kafshë të tjera në gjuhën e synuar: *A leopard cannot change its spots* – kuptimi i të cilës është që njerëzit ose gjërat nuk janë në gjendje të ndryshojnë karakteristikat e tiparet e tyre themelore. Proverbi ekuivalent në shqip është: “Ujku qimen e ndërrohet por zakonet nuk e harron” “Don’t count your chickens before they hatch.” – kuptimi i të cilës është mos e merrni për të mirëqënë diçka që nuk ka ndodhur ende. Në gjuhën shqipe të njëjtën gjë do ta shprehim duke përdorur proverbat: “Peshku në det, tigani në zjarr” apo “Lepuri në mal, kusia në zjarr”. “Don’t burn down the house to scare away mice” – kuptimi i të cilës është: Mos reagoni ndaj një problemi të vogël duke marrë masa drastike. Në gjuhën shqipe kemi proverbin: *Për një plesht djeg gjithë jorganin*. “Never look a gift horse in the mouth” – kuptimi i të cilës është: Tregohuni mirënjohës kur merrni një dhuratë, në vend që ta kontrolloni atë për të parë nëse ia vlen apo ka difekte. Proverbi ekuivalent në gjuhën shqipe është “Gomarit te falur mos i shiko dhembet”. *Don’t set the fox to herd the geese* ose *Don’t let the fox guard the henhouse* – kuptimi i të cilës është: “Mos i cakto një punë dikujt që më pas do të jetë në gjendje ta shfrytëzojë atë për qëllimet e veta”. Proverbi ekuivalent në gjuhën shqipe është: “Vendos ujkun të ruaj dele”. “To cast pearls before swin”. - e cila nënkupton: t’i japësh ose t’i ofrosh diçka të vlefshme dikujt që nuk

e kupton vlerën e saj. Në gjuhën shqipe përdorim proverbin: “*Ku di dhia ç’është tagjia*”

b) Kafshë e zëvendësuar me një symbol tjetër

Speak of the devil and he will appear – Proverbë e cila përdoret kur shfaqet dikush që sapo ka qenë objekt bisede apo sapo është përmendur në një bisedë. Në gjuhën shqipe përdorim proverbin “Kujto qenin bëj gati shkopin”

“If you run after two hares you will catch neither” – e cila nënkupton: Dështimi është i paevitueshëm kur përpiqeni të bëni dy gjëra në të njëjtën kohë. Në gjuhën shqipe për të shprehur të njëjtën gjë themi: Nuk mbahen *dy kunguj nën një sqetull*”.

“A bird in hand is worth two in the bush” – kuptimi i të cilës është: është më mirë të jesh i kënaqur me atë që ke sesa të rrezikosh të humbasësh gjithçka duke kërkuar të marrësh më shumë. Në gjuhën shqipe për të shprehur të njëjtën gjë themi: Më mirë një vezë sot, sesa një pulë mot.

6. Perfundime

Qëllimi i këtij punimi ishte që të vihen në pah ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet proverbave në gjuhën angleze dhe asaj shqipe për sa i përket formës dhe përmbajtjes së tyre. Gjatë analizës së proverbave të sipërpërmendura kemi vërejtur se dallimi midis tyre pasqyrohet më së shumti në përzgjedhjen e kafshëve të caktuara për të përshkruar disa aspekte të qenies njerëzore. Padyshim se ky dallim kushtëzohet nga kultura, tradita dhe simbolet e veçanta. Në të dyja gjuhët dhe kulturat vërejmë shumë ngjashmëri dhe kemi pothuajse simbolikë të njëjtë, si positive ashtu edhe negative në lidhje me kafshët. Referuar proverbave të cilat i sollëm si shembull mund të thuhet se kafshët posedojnë karakteristika të cilat nëpërmjet metaforës i referohen karakterit dhe pozitës së personit në shoqëri. Analiza e proverbave mundëson të kuptojmë më mirë jo vetëm domethënien e tyre por edhe parimet në bazë të të cilave ndërtohen këto proverba.

BIBLIOGRAFIA

MONA BAKER "In other words – A coursebook in Translation"

KINDSTRAND JF (1978) The Greek Concept of Proverbs. Eranos

RUSSO J (1983) The Poetics of an Ancient Greek Proverb. Journal of Folklore Research

MIEDER, W. (2004). Proverbs: A handbook. London: Greenwood Press

MOLLANAZAR, H. (2001). Principles and Methodology of Translation.

NORRICK, N.R. (1985). How Proverbs Mean? Semantic Studies in English Proverbs.

HONECK, R. (1997). A proverb in mind: the cognitive science of proverbial wit and wisdom.

VINAY, J. P., & DARBELNET, P. (1995). Comparative stylistics of French and English: A methodology for translation.

NEWMARK, P A textbook on translation.

THOMAJ(1981). Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe, Tiranë.